



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.
2018

Ballsh, më ____ . ____ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën www.app.gov.al

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 18.10.2018

Për: **Operatorin Ekonomik "FLED" shpk, me NIPT K17621104C, me adresë Lagja "Havaleas", Rruga Ura e Kozares, Kuçovë.**

Procedura e prokurimit: **"E hapur"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-84310-08-31-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Blerje çakull, stabilizant, steril bituminoz për mirëmbajtje rruge në fshatra"**, me fond limit **41.666.667** (dyzetë e njëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, me afat 2 muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.36, datë 10 shtator 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "BIBA-X" shpk, me NIPT K32618815N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 37.460.354,8 (tridhjetë e shtatëmilion e katërqind e gjashtëdhjetëmijë e treqind e pesëdhjetë e katër presje tetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik "FLED" shpk, me NIPT K17621104C, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 39.916.097 (tridhjetë e nëntëmilion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik "GRAND KONSTRUKSION M" shpk, me NIPT L38109801T, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 40.470.780 (dyzetmilion e katërqind e



shtatëdhjetëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “BIBA-X” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Gjatë shqyrtimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është njoftuar nga zyra e protokollit për shkresën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “BIBA-X” shpk e cila mban nr.ex prot, datë 9.10.2018 me lëndë “Njoftim për tërheqje nga procedura e prokurimit”, regjistruar në protokollin hyrës të Bashkisë me nr.2275, datë 09.10.2018. Nëpërmjet kësaj shkrese Operatori Ekonomik “BIBA-X” shpk, njofton se për arsye objektive nuk mund ti përmbahen ofertës së dhënë për shkak se bashkëpunëtorët dhe furnitorët e tij kanë probleme në sigurimin e furnizimit të materialeve dhe për këtë arsye dorëhiqet nga ky prokurim. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik “BIBA-X” shpk dhe ta skualifikojë atë, për shkak se ky operator është tërhequr nga ky prokurim.

2. Operatori Ekonomik “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuara për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar plotësimin e kësaj kërkesë.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se disponon në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me qera ose me kontratë noteriale furnizimi për 1 impiant prodhimi inertesh.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik "FLED" shpk, me NIPT K17621104C**, me adresë Lagjja "Havaleas", Rruga Ura e Kozares, Kuçovë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 39.916.097 (tridhjetë e nëntëmilion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.10.2018

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Agron Kapllanaj

